

LIGJ
Nr. 101/2024

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 43/2016, “PËR MARRËVESHJET
NDËRKOMBËTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 25 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Në rastet kur mënyra e zbatimit të detyrimeve të palës shqiptare në nivel të brendshëm nuk është rregulluar nga vetë marrëveshja bazë apo marrëveshjet zbatuese dhe as nuk buron nga tërësia e rregullimeve të legjislacionit në fuqi, rregullat për mënyrën e zbatimit të këtyre detyrimeve për palën shqiptare përcaktohen rast pas rasti me vendim të Këshillit të Ministrave ose me udhëzim të titullarit të institucionit zbatues të marrëveshjes, në varësi të përmbajtjes së çështjes që do të rregullohet.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.9.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 347, datë 27.9.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**